



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenj / Prilato Received / Delivory	03 - 10 2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHCK	5834/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.715/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, më Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.1702/2021 të datës 15.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.715/2019 të datës 15.11.2019 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi Komuna e Malishevës, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.715/2019 e datës 15.11.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 01/1305 i datës 21.10.2019 i Kryetarit të Komunës së Malishevës, për zgjidhjen e kandidatës të suksesshme për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4", sipas Konkursit me numër reference RN00005278 të shpallur më datë 22.07.2019.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 15.11.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5380/2019, në keshullin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës kundër Vendimit Nr.01/2019 të Komisionit Vlerësues të Konkursit me numër referencë RN00005278 të datës 22.07.2019 për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4", për shkak të mosrespektimit dhe parregullsive nga Komisioni Vlerësues dhe shkeljeve të kushteve dhe procedurave të konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.11.2019 ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankesë të Komuna e Malishevas, ndërsa kjo e fundit më datë 02.12.2019 ka përcjell shkresat lidhur çështjen ankimore.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokollit 5816/2019 të datës 13.12.2019 dhe shkresës me numër protokollit 3560/21 të datës 08.07.2021 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.143/2020 të datës 26.05.2021 dhe A.nr.1702/2021 të datës 15.08.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, tani ankuesit, dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.715/2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër Anr.1702/2021 të datës 15.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi me numër protokollit 3560/2021 të datës 08.07.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; e-mailin e datës 15.06.2021 nga Aktgjykimin me numër A.nr.143/2020 të datës 25.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin me numër protokollit 5816/2019 të datës 13.12.2019 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Ankesën me numër A. nr.715/2019 të datës 15.11.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin nr. 01 i datë 18.10.2019 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Malishevës; Konkursin nr.01/2019 i datës 22.07.2019 me numër reference RN00005278; Kopje e ID-së së ankuesit; Përgjigjen e Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Malishevës me nr.01/1444; Autorizimi nga DASHC të datës 17.07.2019; Lista e gjerë Form. MAP/SHCK-04; Njoftimin nr.01/1484 i datës 08.10.2019; Njoftim nr.01/1211 i datës 13.09.2019; Vendimin më numër protokollit 01/1212 të datës 13.09.2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Njoftimin nr.01/1283 i datës 08.10.2019; Listën për intervistë me gojë Form.MAP-SHCK-04; Regjistri i aplikacioneve i datës 11.10.2019; Renditja Përfundimtare e Kandidateve, Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale Form. MAP/SHCK-09; Raportin Final të Komisionit Përzgjedhës Form. MAP/SHCK-11 i datës 18.10.2019; Njoftimin me numër protokollit 01/1306 të datës 21.10.2019; Njoftoni me numër protokollit 01/1307 i datës 21.10.2019; Vendimin Nr.01/1305 të datës 21.10.2019; Aplikacioni i ankuesit i datës 31.07.2019 se bashku me dokumentacion përcjellës: Certifikatë e lindjes L 2347180 e datës 31.07.2019; Certifikatë PN.NR/KR.Br. 2385/2019; Diplomën nr.5015 e datës 13.03.2015; Diplomën e datës 27.10.2015; Aplikacioni i kandidatit i datës 24.07.2019 se bashku me dokumentacion përcjellës: Certifikatë e evidencës penale e datës 11.04.2019 PN.NR/KR.Br. 1360/2019; Vërtetim me numër protokollit 486/18 i datës 29.06.2018; Certifikatë-ekstrakt E 23128809 të datës 27.12.2018; kopje e ID-së e S. Kelmendit Certifikatë e datës 03.4.2010, Certifikatë Vijues i programit Mësimdhënia me nxënësit në qendër prill 2006; Certifikatë lidhur me pjesëmarrjen në workshopin katër javor për metodologjinë e të mësuarit në gjuhën angleze; Certifikatë trajnimi "Planifikimi i Projekteve Shkollore" e datës 30-31.03.2011; Certifikatë trajnimi "Plani Zhvillimor i Shkollës" 27-28.2011; Certifikatë datë 19, 26 mars 2011; Certifikatë maj 2013; Certifikatë lidhur me përfundimin e kursit themelor "Vlerësimi për nxënie" maj 2013; Certifikatë e gjuhës angleze pre-intermediate e datës 15.05.2015 deri 15.07.2015; Certifikatë për

ndjekje të kursit të kompjuterëve nga data 15-05.2005 deri me 15.07.2005; Diplomën nr.167/16 e datës 07.12.2016; Diplomë nr.680/12 e datës 11.12.2012; Aplikacioni i kandidatës i datës 05.08.2019 se bashku me dokumentacion përcjellës: Vërtetim i lëshuar nga pronari-drejtoi i kompanisë Infinit Konto SHPK, Vërtetim me numër protkollit 30/1087 të datës 05.08.2019, Certifikatë e Evidencës Penale e datës 31.07.2019 PN.Nr.2402/2019; Certifikatë trajnimi "Zhvillimi i shkathtësive sipërmarrëse" të datës 07.12.2016; Certifikatë trajnimi "Bazat e Kontabilitetit" e datës 02.05.2014; Certifikatë Trajnimi "Zhvillimi Profesional" e datës 03-13.10.2016; Certifikatë-Ekstrakt E 22924694 e datës 26.09.2018, kopje e ID-së; Diplomë nr. 043/16 e datës 25.07.2016; Aplikacion nga kandidati i datës 26.07.2019 se bashku me dokumentacion përcjellës: Diplomë Nr.4402 i datës 15.12.2016; Certifikatë A.GJ.I.nr.408/2018 e datës 26.10.2018; Certifikatë nga evidenca penale e datës 26.07.2014 P.nr.2347/2019; Certifikatë-Ekstrakt E 23743792 e datës 26.07.2019; kopje e ID-sw, kopje nga testi me shkrim i datës 24.09.2019 për Vlerësimi individual Form. MAP/SHCK-08a për kandidaten nga pesë anëtarët e Komisionit Përzgjedhës; testi me shkrim për kandidatin testi me shkrim për ankuesin, Vlerësimet Individuale të anterave të Komisionit Përzgjedhës për kandidatin testi me shkrim i kandidatit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithave shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Komuna e Malishevës, në bazë të autorizimit të datës 17.07.2019 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil pranë Ministrisë së Administratës Publike, më datë 22.07.2019 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00005278 për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Bazuar në Raportin Final dhe Përmbledhjen e Vlerësimeve Individuale të Komisionit Përzgjedhës të datës 18.10.2019 kandidatja është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë me gjithsej 85.5 pikë, ndërsa ankuesi me gjithsej 54 pikë duke u renditur si kandidati i katërt. Njësia e Personelit të Komunës së Malishevës me datë 18.10.2019 ka shpallur Njoftimin me numër protokollit 01/1306 për kandidatin e suksesshëm lidhur me pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4", duke shpallur si kandidate fituese Ndërsa, ankuesi i pakënaqur me këtë njoftim, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të mosrespektimit dhe parregullsive nga Komisioni Vlerësues dhe shkeljeve të kushteve dhe procedurave të konkursit.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit sjell në vëmendje faktin së procedura e rekrutimit me numër reference RN00005278 lidhur me pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4", është zhvilluar sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kurse ankesa është parashtruar sipas nenit 24 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka hyrë në fuqi më datë 10.09.2019, i pezulluar me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.:VMP 1472/19 të datës 25.11.2019.

Sipas Konkursit me numër reference RN00005278 për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4", si kritere të pranimit janë përcaktuar: *Arsimi-Bachelor-drejtimi ekonomik, juridik apo ndonjë drejtim që lidhet me këtë vend të punës; Përvoja e Punës: 4 vite përgatitje profesionale*, dhe rrjedhimisht Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit ka gjetur së kandidatja e zgjedhur i lidhur

me kriterin e arsimit posedon Diplomën me numër 043/16 të datës 25.07.2016 për përfundimin e studimeve në Programin Menagjment Gjeneral Internacional duke marr titullin Bachelor i Artave në Menagjment Gjeneral Internacional, kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës e njëjta posedon Vërtetimin me numër protkollli 30/1087 të datës 05.08.2019 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Malishevë sipas të cilit vërtetohet së _____ ka punuar në këtë institucion nga data 16.07.2018 deri me datë 16.07.2019, ndërsa sipas Vërtetimit të lëshuar nga pronari i kompanisë "Infinit Konto SHPK" rezulton së e njëjta ka punuar në këtë kompani në cilësi të Zyrtares së Kontabilitetit nga data 01.06.2015 deri me datë 30.06.2018, andaj mbi bazën e këtyre dëshmime rezulton së kandidatja e përzgjedhur ka plotësuar kriteret lidhur me arsimin dhe përvojën e punës, e në këtë kuptim rrjedh së Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1.arsimimi dhe kualifikimi profesional dhe 1.2 përvoja e punës...".

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të vendosjes së drejt dhe të ligjshme lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ka shqyrtuar në tërësi procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00005278 për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4", dhe rrjedhimisht Kolegje nuk verën ndonjë shkelje që cenon ligjshmërinë e kësaj procedure të rekrutimit.

Duke qenë së kandidatja e përzgjedhur është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë me gjithsej 85.5 pikë, kurse ankuesi si kandidati i katërt me gjithsejtë 54 pikë, Kolegji vlerëson së Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me të cilin është përcaktuar së: "Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë", rrjedhimisht procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilat dispozita përcaktohet së: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës.." kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Pas konstatimeve si me lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.715/2019

Zyle Millaku -GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personalit në Komunë të Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

